


	<p style="text-align: center;"><b>Republika e Kosovës</b>  <b>Republika Kosova –</b>  <b>Republic of Kosovo</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Komuna e Prishtinës</b>  Opština Priština – Municipality  of Prishtina</p>	
---	--	---

<b>Datë/a:</b>	12.11.2018
<b>Për/ Za/ To:</b>	Operatori Ekonomik: "ANEA" n.p.t.
<b>CC:</b>	Departamenti i Prokurimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 07.11.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "ANEA" n.p.t., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Dekorimi i qytetit për festa të fundvitit", me Nr. të Prok: 616 18 115 211 nxjerr:

## V E N D I M

1. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik "ANEA" n.p.t., të dt. 07.11.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Dekorimi i qytetit për festa të fundvitit", me Nr. të Prok: 616 18 115 221, kundër *Njoftimit për anulim të aktivitetit* të AK -së, të datës 01.11.2018 të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Dekorimi i qytetit për festa të fundvitit", me Nr. 616-18-6923-2-2-1, Nr. Brendshëm 616 18 115 221 dhe mbështet njoftimin për anulim të aktivitetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

## A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 14.09.2018 ka bërë njoftimin për kontratë lidhur me tenderin me titull: “Dekorimi i qytetit për festa të fundvitit”, me Nr. 616-18-6923-2-2-1, Nr. Brendshëm 616 18 115 221.

Hapja e ofertave nga Autoriteti Kontraktues është bërë me datë: 12.10.2018 ku të pranishëm ishin Operatorët të cilët kanë ofertuar për këtë tender. Janë pranuar 2 oferta. Autoriteti Kontraktues ka respektuar të gjitha dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik lidhur me mbarë vajtjen dhe ecurinë e procesit të hapjes dhe vlerësimit të ofertave.

Me datë 01.11.2018, Autoriteti Kontraktues ka bërë njoftimin Vendim të Autoritetit Kontraktues pas vlerësimit të ofertave nga ana e anëtarëve për Komision për Vlerësim ku secili anëtar ka dhënë vlerësimin e tij për çdo kriter të paraqitur në dosje.

Me datë 05.11.2018 Operatorit Ekonomik “ANEA” n.p.t. , iu ka lejuar qasja në dokumentacion të të gjitha ofertave lidhur me këtë tender.

Operatori Ekonomik “ANEA” n.p.t, me datë 07.11.018 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Dekorimi i qytetit për festa të fundvitit”, me Nr. 616-18-6923-2-2-1, Nr. Brendshëm 616 18 115 221, kundër Njoftimit për anulimit të aktivitetit të prokurimit të AK -së, të datës 01.11.2018 e publikuar me datë 02.11.2018 të publikuar në web-faqe të KRPP-së, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë 07.11.2018 sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr.04/L-042, në të cilin pretendon:

*a) Pretendimi 1: Operatori Ekonomik i rekomanduar për dhënie të tenderit ka dorëzuar dokumentin “referencë për punë të kryera” i lëshuar me datën 31.10.2018, kurse dorëzimi i ofertave është bërë me datë 12.10.2018 do të thotë 20 ditë më vonë se data që janë dorëzuar ofertat.*

*Sipas ligjit të krpp-së decidivisht thuhet se sigurimi i informacioneve shitesë mund të bëhet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është fiksuar para datës së dorëzimit të ofertave dhe mund të vërtetohet objektivisht.*

*Kurse në këtë rast dokumenti i cili iu është kërkuar OE nuk ka ekzistuar dhe AK e ka pritur OE deri sa e ka nxjerr një dokument të tillë dhe ai dokument është siç e cekëm edhe më lart me datë 20 ditë më vonë sesa data e dorëzimit të ofertave.*

*b) Pretendimi 2: Ne mendojmë se AK nuk ka bërë verifikimin e certifikatës ISO 9001-2015 të OE i propozuar për kontratë edhe pse ka dyshime të bazuara mirë se kjo certifikatë mund të jetë jo valide. Dyshimi është se pikë së pari web faqe e dhënë në këtë certifikatë ku do të duhej të bëhej verifikimi, është jo valide dhe nuk hapet, dyshimi kryesor është se si është e mundur një kompani të marrë certifikatën ISO për ndriçim dekorativ kurse në informatat e biznesit nuk e ka fare këtë veprimtari të regjistruar.*

*Kërkojmë nga AK që të rishqyrtoj aktivitetin e prokurimit në fjalë.*

#### **I. Baza ligjore për refuzim të kërkesës.**

Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësimin e ofertave duke bërë ekzaminimin e të gjitha dokumenteve të prezantuara në ofertat e pranuar.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e ofertave ka zbatuar së pari nenin 6 (Parimi i Efikasitetit dhe Ekonomizimit) dhe nenin 7 (Parimi i Barazisë / jo diskriminimit) të Ligjit për Prokurimin Publik të konsoliduar me Nr. 04/L-042.

Autoriteti Kontraktues hedhe poshtë pretendimin e OE dhe njëherit konfirmon se KK Prishtina ka vlerësuar ofertat ne përputhje me LPP-ne.

**Pretendimi 1: Autoriteti Kontraktues e ka vlerësuar tenderin e operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie lidhur me punët e kryera dhe referencat sipas FTD-së.**

Operatori Ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ka dorëzuar listën e kontratave të realizuara sipas aneksit në dosje të tenderit me ç’rast në kontratën e realizuar me titull: “Dekorimi i Sheshit Zahir Pajaziti - Nëna Terezë - Ibrahim Rugova” Lot I dhe II ka realizuar shërbime në vlerë prej 67,008.00 €. Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime lidhur me kontratën e tillë se a është realizuar dhe si rezultat i tillë nga dokumenti ekzistues (Kontrata e nënshkruar) është dokumentuar me Referencë nga kërkesa e OE tek Drejtoria e Shërbimeve Publike se duhet të i lëshohet referenca për shërbimet e realizuara. Autoriteti Kontraktues në bazë të dispozitave ligjore ka të drejtë të kërkoj sqarime shtesë për një dokument ekzistues në ofertë gjithnjë. Operatori Ekonomik brenda dy ditëve ka sjellur sqarimin e kërkuar sipas afatit ligjor.

**Provë 1:** Referenca e datës 31.10.2018, me nr. 07-422/01-0261119/18 - Drejtoria e Shërbimeve Publike

**Provë 2:** Emaili i konfirmuar nga Drejtoria e Shërbimeve se kontrata është përfunduar me sukses dhe referenca është lëshuar nga kërkesa e OE pas sqarimeve për kontratës si dokument ekzistues në ofertë.

**Pretendimi 2: Autoriteti Kontraktues ka bërë verifikimin e certifikatës ISO 9001-2015 dhe vërtetohet se Certifikata është lëshuar nga Certificate and Inspection Bulgara (CIB).**

Autoriteti Kontraktues duke marrë përbazë të gjitha dokumentacionet në shqyrtim dhe vlerësim vërteton se Certifikata ISO 9001-2015 - Link Media Plus është valide dhe përmbush kërkesat e dosjes së tenderit.

**Provë 1. Certificata ISO 9001-2015 e datës: 20.09.2018 - CIB**

**Provë 2: Konfirmimi zyrtar nga CIB se kompania Link Media Plus është e pajisur me Certifikatë ISO 9001-2015.**

Andaj duke u bazuar në të gjitha provat dhe argumentet e prezantuara si dhe duke zbatuar dhe respektuar Ligjin për Prokurimin Publik, Rregullat e Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik si dhe Rregullat për tenderët jo-normalisht të ulët , Autoriteti Kontraktues vendos si në dispozitivin e cekur më lartë.

**Këshilla juridike:**

*Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.*

**Zyrtari përgjegjës i Prokurimit**